



Djali i Madonnës tani është shoqëri e lartë

David i cili para një muaji ka jetuar në një jetimore në Malawi, me një veshje të dizajner luksoze iu është bashkangjitur nënës së tanishme, Madonnës dhe fëmijëve të saj, në udhëtimin e klasisit të parë nga Londra për në

New York. Babai i tij, Yohane Banda ka pohuar se në afërsi të këngëtares së pasur dhe familjes së saj do të jetojë i bekuar. Për këtë arsye ai i ka sulmuar organizatat e shumta, të cilat e kritikojnë Madonnen duke e krahasuar djalin e saj të

adaptuar me një valixhe. Pos tjerash ai i ka pyetur: "Ku keni qenë kur djali im gati ka vdekur nga uria dhe sëmundja". Madonna, në afërsi të saj, për në udhëtim ka pasur djalin gjashtëvjeçar Roccon dhe vajzën dhjetëvjeçare

Lourdes. Babai Guy nuk ka qenë në afërsi të tyre, ndërsa tabloidët pohojnë se ai nuk mund të pajtohet me faktin e adoptimit të djalit sepse ka dashur që Madonna të ketë edhe dy fëmijë tjerë.

Paul McCartneyn ka dashur ta braktisë Linda

Linda ka ditur të jetë e palumtur dhe me një rast shumë seriozisht ka menduar ta lërë Paulin vërtet gazetën "Mail on Sunday". "Në një krizë të thellë ka menduar rreth asaj, që ta lëshojë McCartneyn", ka thënë botuesi Peter Cox, mik i Lindës për

gazetën. Ajo ka hequr dorë sepse ka dashur me çdo çmim ta ruajë familjen. Por, në momentet më të vështira të martesës "është ndër si në kurth", ka thënë Cox, duke shtuar se si e ka njohur "pjesën e errët" të Paulit. Sipas shkrimeve të mediave britanike, McCartney, 64,

e ka lutur Coxin që "xhirimet e Lindës" të mos i publikojë. "Daily Mirror" e ka bërë të ditur se për Paulin do të ishte jo vetëm keq por edhe shumë shtrenjtë, nëse zërat e mendimit të ish-bashkëshortes së tij do të ishin publikuar në gjyqin e shkurtorë

Tingulli i 3nt dhe Genta Ismaili favoritë

Në festivalin tradicional "Zhurma Awards" do të ndahen më shumë se njëzet e pesë çmime në kategori të ndryshme nga muzika popullore deri te rock e rap albumi i vitit.

Adelina Rafuna
adelina.rafuna@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 30 TETOR — Njëri nga spektaklet e shumta muzikore në Kosovë është ndarja ceremoniale e përvitshme "Zhurma Awards", i cili sivjet feston ditëlindjen e tij të njëmbëdhjetë me radhë.

Festivali "Zhurma Awards" karakterizohet si njëri nga spektaklet që nuk përton t'i japë çmime gati të gjitha kategorive të muzikës, duke filluar nga rrymat më të vjetra deri te ato popullore. Në Zhurma Award askush nuk mbetet duar thatë.

Vitin e kaluar organizatorët e festivalit "Zhurma Awards" ishin përkujdesur që askënd të mos e lënë duar thatë, për katër orë sa zgjati festivali janë ndarë mbi dyzet çmime.

Në edicionin e fundit të festivalit "Zhurma Awards" më të kënaqurit ishin rap grupi Etnoengujit, të cilët grabitën numrin më të madh të çmimeve.

"Edhe këtë vit festivali do të mbahet me 9 nëntor edhe pse ende nuk kemi vendosur se ku do të mbahet. Të gjitha përgatitjet rreth tij janë në përfundim e sipër", tha presidenti i kompanisë së njohur, "Ziko" organizatori i "Zhurma Awards".

Nën transmetim të drejtpërdrejtë spektakli pritet t'i tubojë shumë yje të estradës kosovare të cilat kanë qenë prezent me projektet e tyre gjatë vitit 2006.


Kësaj radhe tri herë i nominuar është rep grupi Tingulli 3nt feat. Elvana Gjata, për Hip Hop & Rep kënga më e mirë, për Albumin më të mirë dhe për Hip Hop & R&B videoklipin më të mirë.



Kënga më e përmendur muajt e fundit ka qenë padyshim kënga e Tingulli i 3nt feat Elvana Gjata, të cilët më javë të tëra radhë ishin nëpër vendet e para të top listave tona.

Edhe kënga fituese e festivalit evropian, i klipit "Posesiv" dhe Genta Ismaili është e nominuar në dy kategori, në Pop & Rock kënga më e mirë dhe Pop & Rock albumi më i mirë, dy herë e nominuar është edhe kënga "Do të digjesh", kënduar nga Leonora Poloska.

Ziko, tregoi për Express se tri çmimet kryesore në këtë festival janë Top kënga më e mirë e vitit, Top Albumi më i mirë si dhe Top spoti më i mirë i vitit.



Vlora Maxhuni
vlora.maxhuni@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 30 TETOR — Dy-tri pika lot që rrodhën në faqet e regjisorit Agim Sopi menjëherë pas shfaqjes së filmit të tij "Anatema" nuk erdhën rastësisht, nuk ishin as nga emocionet e tepërta që vinin nga premiera.

Skenat e tmerrshme që kishte paraqitur në filmin e tij, Sopi i kishte parë më sy të vet, i kishte përjetuar ato. Skena që të pranishmëve në sallë arritëm t'ua prishin ditën, sado të buzëqeshur që u futën në sallë.

Nëpërmes filmit të tij, Sopi solli një imazh real të luftës së fundit në Kosovë, një të vërtetë të trishtueshme që tashmë kosovarët kanë filluar ta harrojnë.

Agim Sopi solli vajin, ikjet e refugjatëve, plumbat e automatikëve në trupin e njomë të fëmijëve, shfrenimet e ushtarëve serbë mbi trupat e grave kosovare, hyrjen e trupave të NATO-s, burgjet si dhe lakminë e njerëzve pas luftës dhe

Autokantarzisi


Regjisori Agim Sopi si duket i shpëtoi anatemës financiare të kinematografisë sonë. Sopi solli një imazh të vërtetë të luftës së fundit në Kosovë. E realizoi atë me mjaft guxim dhe maturi. Premiera e filmit të tij "Anatema" u dha mbrëmë në

humbjen e humanitetit në shpirtat e tyre. Të gjitha këto emociione u interpretuan me një ekip gjigant të aktorëve më të mirë të kinematografisë kosovare si Çun Lajqi, Enver Petrovci, Lumnie Sopi, Blerim Gjoci, Blerta Sylja, Safete Rugova, Arta Muqaj, etj, si dhe aktori amerikan Doug Barron.

"Eshhtë ndoshta filmi i parë që është punuar krejtësisht nga një ekip shqiptar në të gjitha segmente teknike, autoriale etj. Eshhtë një sprovë reale kinematografike. Eshhtë përfolur

mjaft shumë se në Kosovë mungojnë segmente të ndryshme kinematografike dhe unë mendoj se e kam dëshmuar me këtë film se në Kosovë nuk mungojnë segmentet kinematografike. Ka ekepe shumë profesionale që mund dhe dinë të bëjnë film, në Kosovë mungojnë paratë", tha regjisori Agim Sopi, në konferencë për gazetarë.

Realizimin e filmit "Anatema", Sopi e kishte filluar me një buxhet mjaft modest, diku 300 mijë euro sa kishte ndarë Minis-



trë e Kulturës së Kosovës, si dhe me bashkëpunimin e kompanisë "AS Film Production". Ngatërrimet e ndryshme teknike shpenzuan kohën dhe paratë, kështu që Sopi iu bashkëngjiti edhe kompania e produksionit "Lara Entertainment" dhe në fund filmi arriti një shumë totale prej 700 mijë eurove. Sidoqoftë Sopi morri guximin, të shkruaj dhe ta realizoj një film me një temë goxha delikate, film i cili shtjellon ngjarje shumë të rëndësishme në

historinë e Kosovës. Protagonistja e filmit "Anatema", Lumnie Sopi, luan rolin e Emës, një gazetare e luftës e cila raporton nga linja e frontit së bashku me dy gazetarë amerikanë. Pas ashpërsimit të gjendjes, gazetarëve amerikan iu vjen urdhri që të tërhiqen nga Kosova, kurse gazetarja shqiptare ngel dhe i kthehet familjes në Prishtinë. Ajo gjithashtu detyrohet të ik bashkë me familjen diku në një kamp refugjatësh, ku edhe përdhunohet nga for-

cat serbe bashkë me disa vajza të tjera.

Pas përfundimit të luftës ajo kthehet në Kosovën e djegur, por rrethina e saj ia kthen shpinën, e sidomos me lindjen e një foshnje që nuk dihet se a është fryt i dashurisë dhe i martesës së saj, apo i përdhunuesve serbë. Pikërisht këtu filmi shënon edhe fillimin e luftës së saj për mbijetesë.

"Filmi nuk akuzon askënd. Filmi trajton dramën e një gazetareje që merr guximin të përballet me perënditë e luftës. Normalisht që ka shumë dukuri negative në jetën tonë pas luftës", vazhdoi Sopi.

"Anatema" pati mjaft lëvdanta, si dhe përrurime për guximin e autorit Sopi për të trajtuar një temë të tillë. Megjithatë nuk do të thotë që disa skena nuk kishin mangësitë e veta. Të tillat shpeshherë mbuloheshin nga grumbulli i madh i aktorëve më të mirë kosovarë.

Sido që të jetë, Sopi arriti t'i shpëtojë anatemës financiare që ka kinematografia shqiptare. Ai kësaj kinematografie i solli diçka, diçka të mirë.